



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

Data: 28.2.2025

Nr: 13

Ora: 12:30

**VENDIM**  
**PËR**

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT, NË**  
**ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “ë” dhe pika 2, shkronja “c”, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**VENDOSI:**

1. Në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në të gjitha Qendrat e Votimit të Njesisë Administrative nr. 10 të Bashkisë Tiranë dhe në të gjitha qendrat e votimit të njësive administrative të Bashkisë Vorë, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Operatorët për funksionimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN), do të emërohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar (Pro)**

**Arens ÇELA**

**Anëtar (Pro)**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar (Pro)**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar (Pro)**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar (Kundër)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

**Lidhja 1**

Njësitë administrative të Bashkisë Tiranë dhe Vorë në të cilat procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN):

Bashkitë	Njësia administrative	KZAZ-të	Numri i QV-ve
Tiranë	Nr.10	41	31
Vorë	Bërxull	27	12
	Prezë		7
	Vorë		25
<b>Totali QV</b>			<b>75</b>

*Shënim: Për çdo Qendër Votimi do të përdoren dy pajisje të votimit dhe numërimit elektronik*